



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. Dep. 2-D/DPK Nr Prot. Br Prot. Prot No. 01-1157/15
 Nr. Itau. Data Datum 15-04-2015
 Nr. pages 02 SHKËMBIME



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	14.04.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPK-03/15
PËR/ZA/TO:	z. Driton Lajçi, Këshilltar Politik në Ministrinë e Drejtësisë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik



I nderuari z. Lajçi,

Lidhur me kërkesën tuaj të drejtuar Agjencisë kundër Korrupsionit, ju njoftojmë se; në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (L.P.K.I), Agjencia; “bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe për regjistrimin rast për rast të interesave”, (Neni 19 (paragrafi 1.5) i Ligjit nr.04/L-051), lidhur me kërkesën tuaj, Agjencia Kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Ushtrimi i funksionit publik si Këshilltar Politik në Ministrinë e Drejtësisë dhe angazhimi i juaj në funksionin tjetër publik si Menaxher i Shitjes me Institucione në Ndërmarrjen Publike Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A, paraqet kufizim të zyrtarit të lartë në ushtrimin e funksioneve tjera, krahas ushtrimit të funksionit publik.

Zyrtari i lartë publik nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhuese në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse.

ARSYETIM

Në kuadër të ushtrimit të kompetencave ligjore, përkatësisht sipas nenit 5 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia është autoritet qendror i cili ndër të tjera bën edhe mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit si dhe ndërmerr masat e parapara ligjore.

Rrjedhimisht, çështja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik është e rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Në bazë të këtij Ligji pozita e Këshilltarit Politik hynë në kategorinë e zyrtarëve të lartë publik.

Sipas këtij ligji, të gjithë zyrtarët e lartë publik kanë për obligim parandalimin e konfliktit të interesit dhe kanë për detyrë të zgjidhin vetë brenda afatit ligjor, dhe në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tyre të interesit (neni 8, par. 1).

Lidhur me pyetjen tuaj se a ekziston konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik si Këshilltar Politik në Ministrinë e Drejtësisë dhe angazhimi i juaj si Menaxher i Shitjes me Institucione në Ndërmarrjen Publike Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, në nenin 16 të tij ka përcaktuar kufizimet e zyrtarit të lartë në ushtrimin e funksioneve tjera, krahas ushtrimit të funksionit.

Në piken 1 të këtij neni thuhet:

“Zyrtari i lartë publik nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhuese në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, përjashtuar subjektet politike, si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet për shkak të funksionit”.

Bazuar në këtë dispozitë është e qartë se z. Lajçi si zyrtar i lartë – Këshilltar Politik në Ministrinë e Drejtësisë, nuk mund të ushtroj njëkohësisht edhe funksionin tjetër publik si Menaxher i Shitjes me Institucione në Ndërmarrjen Publike Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A, prandaj ju rekomandojmë që të veproni konform këtij opinioni, dhe të njoftoni Agjencinë për hapat e ndërmarra.

Me respekt!